

REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Zhvillimit Ekonomik / Ministarstvo Ekonomskog Razvoja
Ministry of Economic Development

Nënie Org. / Org. Unit: NDPMNP Nr. Prot. / Prot. No: 543

Nr. i faqeve / Broj stranica: 1 Data / Datum: 18.03.2013


PRISHTINË/A

KMDK SH.A

Dalëse
Hyrëse

Nr: 236/13
Data: 18.03.13

Kompanie për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A
Kosovo Landfill Management Company J.S.C.
Kompanija za Upravljanje Deponijama na Kosovu DD



Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A
Kosovo Landfill Management Company J.S.C
Tel: 038 544 551 dhe 544 552
Adresa: Nazim Gafuri nr 33 (Rruga për Gërm)
Prishtinë, Republika e Kosovës

Raporti Vjetor i Ndërmarrjes Publike Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A

RAPORTI VJETOR 2012 I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORVE DHE TË KRYESHEFIT EKZEKUTIV TË NP KMDK SH.A PËR NJESINË E MONITORIMIT TË NDERMARRJEVE PUBLIKE - MINISTRIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

1. Përmbajtja	2
2. Raporti i Kryesuesit të Bordit të Drejtoreve	3
2.1. Aktivitetet dhe performanca e ndërmarrjes	3
a-Aktivitetet kryesore të ndërmarrja gjatë vitit 2012.....	3
b-Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak.....	4
c-Ngjarje të cilat ndikojnë në të ardhmen e ndërmarrjes.....	7
d-Një pasqyrë e të priturve për vitin e ardhshëm sipas planit të Biznesit për vitin 2012.....	7
2.2. Informacione lidhur me kapitalin dhe dividenden	8
f-Kreditë e rëndësishme të nënshkuara apo te paguara gjatë vitit.....	8
g-Investimet e rëndësishme gjatë vitit 2012.....	8
gj-Dividendat e paguara gjatë vitit.....	8
2.3. Të dhëna për drejtorët jo-ekzekutiv	8
h-Emrat e drejtorëve të bordit, duke përfshirë kompensimet, shpenzimet dhe pagesat.....	8
i-Numri takimeve të Bordit gjatë vitit dhe numri pjesëmarrjes së drejtorëve në takime.....	9
j-Komitetet e Bordit, përbërja e tyre dhe numri takimeve të mbajtur.....	9
2.4. Informacione tjera --Raportimet të nevojshme për aksionarin	9
k-Sponsorimet dhe donacionet.....	9
l-Raportet e auditorit të brendshëm.....	9
ll-Raporti mbi vetëvlerësimin e bordit të drejtorëve.....	10
2.5. Raportimet sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike	10
m-Pasqyra e Strukturës organizative të NP, Organogrami dhe komentet.....	11
n-Shqyrtimi performancës afariste dhe financiare gjatë tremujorit tetor-dhjetor 2012.....	12
nj-Përmbledhja e procedurave gjyqësore gjatë vitit 2012.....	13
o-Përmbledhja e procedurave gjyqësore për 2013.....	14
p-Transaksionet e konsiderueshme që përfshin NP.....	14
q-Sugjerime dhe propozime për ndryshime të cilat me arsye pritet që ta rrisin performancën.....	14
3. Raporti i Kryeshefit Ekzekutiv	16
3.1. Ngjarjet kryesore të vitit.....	16
3.2. Pasqyre të performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performances.....	17
3.3. Pasqyre të performances financiare dhe rezultatet.....	20
3.4. Progresi me planin e biznesit.....	22
3.5. Shpenzimet kapitale dhe projekteve.....	23
3.6. Perspektiva për vitin e ardhshëm.....	24
3.7. Rreziqet e të ardhmes së korporatës.....	24

2. Raporti i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve

Raporti i kryesuesit të Bordit për vitin 2012. është hartuar në emër të anëtarëve të bordit të drejtorëve dhe ai siguron një pikëpamje strategjike, gjithëpërfshirëse të ndërmarrjes dhe vështirësive me të cilat ballafaqohet ndërmarrja, së bashku me të dhënat mbi qeverisjen korporative të ndërmarrjes publike.

2.1 Aktivitetet dhe performanca e ndërmarrjes

Në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK SH.A) është kompania e vetme si autoritet përgjegjës e legalizuar, e licencuar dhe ne procedure të rregullte për ta rimarre licencën, për menaxhimin e deponive sanitare regjionale të mbeturinave Komunale në Republikën e Kosovës, e koorporatizuar dhe plotësisht e regjistruar si shoqëri aksionare sipas Ligjit mbi Shoqëritë Tregtare Nr. 03/ L-123.

Duke marrë parasysh natyrën e shërbimeve për deponimin e mbeturinave komunale, roli i KMDK SH. A është esencial- në parandalimin e ndotjes së Ambientit, të keqpërdorimit potencial të këtij shërbimi si dhe roli i rëndësishëm se veçante është stimulimi i efikasitetit ekonomike dhe ofrimi i shërbimeve cilësore për konsumatorët e këtyre shërbimeve. Këtë rol KMDK SH.A e ushtron duke shfrytëzuar Ligjet dhe mekanizmat rregullator që i ka në dispozicion.

a-Aktivitetet kryesore të ndërmarrja gjatë vitit 2012.

Aktivitetet kryesore të ndërmarrja në Kompaninë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë kanë qenë në përputhshmëri me Ligjin mbi Ndërmarrjet publike, Ligjin mbi Shoqëritë tregtare, me politikat e Qeverisë për NP, me Qeverisjen korporative dhe me Kodin e Etikës, gjithnjë duke i zbatuar politikat e Aksionarit e me qëllim të rruajtjes së vlerave të asetëve.

Aktivitetet kryesore kanë pas të bëjë me krijimin e kushteve që Kompania të realizojë synimet e parapara sipas Planit të biznesit. Çështjet e dinamikës së operativeve nëpër Deponi kanë qenë dhe tani janë aktivitetet e dorës së parë, krahas aktiviteteve për çështjet e financave- marre parasysh shkallen e ultë të inkasimit e cila ka shkaktuar grumbullim të lartë të borxheve të klientëve – KRM-ve ndaj KMDK-se. Në fokus të aktiviteteve kanë qenë aplikimi procedurave gjatë proceseve të prokurimit si dhe orvatjet e përditshme të menaxhmentit dhe të përgjegjësve të operativeve në racionalizimin e shpenzimeve në të gjithë sektorët e punës në KMDK, me përkushtim të posaçëm për shfrytëzimin e grandëve, që do ndikojnë në ngritjen e performancës teknike të infrastrukturës për qasje me të mirë në Deponi, si dhe të para përgatitjes së makinerisë së rëndë të Ndërmarrjes për aktivitete të suksesshme për menaxhim cilësor të hedhurinave. Çështja e shfrytëzimit të mjeteve të grandëve të dhëna nga Qeveria – gjegjësisht nga MZHE-ja, kanë qenë aktivitete me obligime të nivelit më të lartë, me qëllim që mjetet e dhëna të shfrytëzohen për avancimin e aktiviteteve të Kompanisë, e në favor të krijimit të kushteve sa më të mira për klientë.

Gjithsesi, se pjesë e rëndësishme së veçanet në KMDK kanë qenë aktivitetet e Menaxhmentit për lidhjen e ujdive-marrëveshjeve me KRM- të për kompensimin e borxheve të vjetra, gjë që është realizuar duke nënshkruar tri marrëveshje me KRM-të dhe fal kësaj iniciative dukshëm është rritur inkasimi në vitin 2012. Vlen të ceket se aktivitete të dendura kanë qenë lidhur me Rekomandimet të Auditorit gjeneral dhe Letër me Rekomandimet për Menaxhmentin. Mund të konstatohet se Rekomandimet janë realizuar në shkallë të pritur nga Menaxhmenti dhe nga

Kompania në përgjithësi. Është mendimi përgjithshëm në Kompani, se disa aktivitete janë realizuar në bazë të sugjerimeve të NJPMNP, e në mbështetje të LNP.

b-Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe aktual.

KMDK ne vitin 2012 ka qenë e përballur me vështirësi të pagesave nga Kompanitë Regjionale dhe mos pagesave të KMDK-se ndaj Furnitorëve të KMDK-se⁷

KMDK ka ne dispozicion asetë të cilat janë të vjetërsuara dhe për këtë arsye kemi prishje të shpeshta të tyre të cilat për riparimin e tyre kërkojnë një kosto të lartë.

Të dhënat e performancës dhe objektivat	2012	2011
Numri i klientëve të rregullt	22 ¹	45
Mbeturinat e hedhura	195,729	205,727
Faturimi	€ 1,034,106	€ 1,082,122
Inkasimi	€ 865,360	€ 669,491
Grandët	€ 143,191	€ 344,403
Shpenzimet ne operim , (p.sh amortizimi)	€ 1,021,350	€ 1,021,336
Shpenzimet e investimeve	€ 67,175	€ 58,000
Shpenzimet operative	€ 888,406	€ 1,076,795 ²
Llogaritë e arkëtueshme	€ 2,704,105	€ 934,245
Llogaritë e pagueshme	€ 570,370	€ 610,618
Paratë e gatshme dhe paratë ne banke	€ 20,206	€ 10,018
Numri i të punësuarve	51	46

¹ Planifikimi i klientëve në vitin 2012 ka qene 50 (5 klientë KRM dhe 45 klientë privat), deri në fund të Shtatorit kemi operuar me këta klientë ndërsa në fillim Tetorit është reduktuar numri i klientëve në 22 (5 KRM dhe 17 privat) për arsye të mos pajisjes me licenca nga organet kompetente.

² Shpenzimet operative të vitit 2011 kanë qene 1,076,795 Euro, duke përfshire edhe lejimin e borxheve të këqija në vlere prej 346,961 Euro. Shpenzimet për ton ka ndalur të jene 10.19 Euro e jo 8.51 siç është raportuar në raportin e vitin 2011. Ky ndryshim si rezultat i mos përfshirjes së borxheve të këqija të rekomanduara nga Raporti i Auditorit të Jashtëm.

Rritja e numrit të klientëve		
Shkalla e inkasimit (total)	84%	62%
Norma e mbulimit me punë	0.92	0.62
Norma e punës	1.12	1.06
Tarifa mesatare	5.31	5.26
Shpenzimet operative për ton	€ 9.86	€ 10.19

Gjatë vitit 2012 KMDK ka pasur rënie të faturimit për 5% në krahasim me vitin 2011.

Inkasimi për vitin 2012 është ngritur për 22% në krahasim me vitin 2011, ku ne vitin 2011 ka qene 62%, ndërsa ne vitin 2012 inkasimi është 84 %

Shpenzimet operative kanë pasuar rënie për vitin 2012 për 21 % në krahasim me vitin paraprak 2011- si indikator i rënies se shpenzimeve janë lejimet për borxhet e këqija dhe të dyshimta.

Shpenzimet operative për ton në vitin 2012 janë 9.86 € - ne krahasim me vitin 2011 shpenzimet operative për ton kanë qene 10.19 €.

Shpenzimet e amortizimit janë në vlerë prej 1,021,350 €

Performanca financiare e KMDK për vitin 2012 duke i përjashtuar shpenzimet e amortizimit del me një trend pozitiv prej 299,879 €.

Të dhënat krahasuese me caqet e planit të biznesit

Të dhënat e performancës dhe objektivat	Realizimi 2012	Planifikimi biznesit 2012
Numri i klientëve të rregullt	22	50
Mbeturinat e hedhura	193,608	209,580
Faturimi	€ 1,034,106	€ 1,103,825
Inkasimi	€ 865,360	€ 1,103,825
Grandët	€ 143,191	€ 358,000
Shpenzimet amortizimi	€ 1,021,350	€ 1,021,325

Shpenzimet e investimeve	€ 67,175	€ 358,000
Shpenzimet operative	€ 888,406	€ 1,095,447
Llogaritë e arketueshme	€ 2,704,105	€ 950,000
Llogaritë e pagueshme	€ 570,370	€ 600,000
Paratë e gatshme dhe paratë ne banke	€ 20,206	€ 32,500
Numri i të punësuarve	51	50
<hr/>		
Rritja e numrit të klientëve		0%
Shkalla e inkasimit (total)	84%	100%
Norma e mbulimit me punë	0.92	1
Norma e punës	1.16	1
Tarifa mesatare	5.31	5.26
Shpenzimet operative për ton	€ 9.86 ³	€ 8.51

KMDK ka synuar që realizimi i inkasimit të jetë 100% ndërsa KMDK ka realizuar inkasim vetëm 84% - si indikator i performances negative ne realizimin e planit të biznesit për këtë pike janë mospagesa e borxheve të KRM dhe mosrespektimi i Marrëveshjeve të KRM dhe KMDK.

KMDK ka planifikuar të ketë grandë nga Buxheti i Kosovës për vitin 2012, në shume prej 358,000 euro, por për shkak të shkurtimit të mjeteve buxhetore nga Qeveria e Kosovës, kemi realizuar vetëm 143,191 euro.

Shpenzime operative kane qene me të vogla për 23% në krahasim me ato të planifikuara të vitit 2012.

Llogarit e arkëtueshme janë paraqit në baze të lejimit të provizionimit të borxheve të këqija të cilat kërkohen me standarde të kontabilitetit.

Shpenzimet operative për ton në vitin 2012 janë 9.86 € - ne krahasim me shpenzimet e planifikuara për ton në vitin 2012 - të cilat kane qene 8.51 €. Pra këtu kemi një ngritje të

³ Shpenzimet operative për ton kane qene me të larta së të tarifa e përcaktuar nga ZRRUM.

Indikatorët e rritjes se shpenzimeve ne operim janë: Përcaktimi i tarifës së ulet, rritja e derivateve të naftës dhe pjesëve rezerve, makineria e vjetërsuara të Kompanisë.

shpenzimeve operative prej 17,7 % për ton të mbeturinave të menaxhuara neper deponite sanitare të KMDK-se.

c-Ngjarje të cilat ndikojnë në të ardhmen e ndërmarrjes

Top çështjet të cilat do mund ta përcaktojnë të ardhmen e KMDK-se janë :

Krijimi konditave më të volitshme në vazhdimësi të infrastrukturës së Deponive për klientët tanë. Përmirësimi Raporteve afaristë me KRM-të. Zgjidhja e çështjes së obligimeve financiare të rregullta mujore të tyre. Realizimi i Marrëveshjeve për Programimin e borxheve të KRM-ve dhe të Borxheve të KMDK-së ndaj klientëve. Shkalla e inkasimit të të hyrave nga Klientët .

Gatishmëria teknike dhe furnizimi duhur me Makineri të rendë për nivelin e duhur të Operativës nëpër Deponi. Trajtimi Ujërave të ndotura të Deponisë në Mirash si dhe Trajtimi dhe Riciklimi i mbeturinave.

d-Një pasqyrë e të priturve për vitin e ardhshëm sipas planit të Biznesit për vitin 2013.

Nga aspekti Potencialit për arritjen e Planit të biznesit në vitin 2013, Kompania për Menaxhimin e Deponive , planifikon ngritje të sasisë se mbeturinave për 2 % në 4 deponitë sanitare dhe në stacionin e transferit, mirëpo pak do ketë gjasa qe ky qellim të realizohet marre parasysh aktivitetet qe janë duke u zhvilluar ne disa komuna si Gjakova, Ferizaj , Gjilani dhe Fushe Kosove, lidhur me trajtimin dhe riciklimin e mbeturinave.

Nga aspekti aktiviteteve thelbësore të biznesit në vitin 20123. operacionet e duhura do jenë ato në favor të punëve të operativës nëpër deponi , si dhe për makineri dhe riparime të tyre , shpenzime këto të cilat do të mbulohen përmes kontratave ekzistuese në vazhdimësi. Punë shtesë për furnizimin e shërbimeve do të tenderohen gjatë vitit 2013.

Me qëllim të sigurimit të cilësisë më të mirë të shërbimeve për klientët , KMDK-ja do të veprojë në favor të ndërmarrjes së masave të shpejta dhe efikase ndaj kërkesave të arsyeshme dhe nevojave tjera të klientëve.

Nga aspekti i analizave financiare, gjatë vitit 2013. Kompania për Menaxhimin e Deponive do të orientohet drejt krijimit të profitit. Si ndërmarrje publike me tarifa të rregulluara, të gjitha përfitimet e mundshme ekonomike do ti takojnë drejtpërdrejt të gjitha komuniteteve të Kosovës.

Kompania synon që të mbulojë të gjitha kostot operative të Ndërmarrjes, me përjashtim të amortizimit, me të ardhura nga paratë e gatshme.

Nga aspekti i analizës së të hyrave, gjatë vitit 2013, KMDK-ja planifikon që të ngritë vazhdimisht të hyrat operuese nga klientët standard (kompanitë për grumbullim të mbeturinave) si dhe nga klientët e kontraktuar dhe klientët tjerë.

Kompania do të ngarkojë koston e plotë të hedhjes së mbeturinave mbi kompanitë për grumbullim të mbeturinave dhe klientët tjerë privat , që do të thotë , se pagesat do të caktohen për të mundësuar kompaninë që të mbulojë kostot e plota për ofrimin e shërbimeve.

Në periudhën vijuese ngritja e shkallës së mbledhjes të të hyrave dhe mbledhja e borxheve nga vitet paraprake nga KRM-të , do të mbetet një nga prioritetet më të larta të menaxhmentit

KMDK-ja ka dy qasje kryesore për të ngritur inkasimin :

Përmes Marrëveshjeve në mes të KMDK-së dhe Kompanive Regjionale për Mbeturina - me që rast do të ushtrohet një presion afarist mbi kompanitë grumbulluese të mbeturinave, që të paguajnë borxhet e vjetra dhe faturat aktuale mujore, ndërsa po që se dështon veprimi i sipërm, si opSION i fundit- do jetë zgjidhja e kësaj çështjeje përmes Institucioneve gjyqësorë.

2.2 Informacione lidhur me kapitalin dhe dividendën

f-Kreditë e rëndësishme të nënshkruara apo të paguara gjatë vitit

Kompania për Menaxhimin e Deponive KMDK SH.A nuk ka aplikuar për kredi gjatë vitit 2012.

g-Investimet e rëndësishme gjatë vitit 2012.

- Investimet në Infrastrukturë nëpër Deponitë sanitare regjionale, duke cekur ne veçanti Instalimin e Peshores-Urës matëse digjitale-elektronike për matjen e mbeturinave ne hyrje të Deponise ne Mirash-Prishtinë
- Investimet në makinerinë e rëndë, punët e riparimit të makinerisë
- Investimet për Trajtimin e Ujërave të zeza, ne veçanti përfundimi i Lagunës se Ujërave të zeza ne Deponine e Landovices në Prizren

Investimet nga Grandet e MZHE-së	Vlera
1. Rregullimi i Infrastrukturës neper deponite regjionale te ujerave te zeza të KMDK-se	57.995,00 €
2. Obligime ndaj furnitorit Kastrioti për shërbimet e kryera	30,000.00 €
3. Subvencionim për derivate te naftës për KMDK-ne,vlera	55,196.00 €
Gjithsejte vlera e grandeve:	143,191,00 €

gj-Dividendë të paguara gjatë vitit

KMDK-ja , gjatë vitit 2012 nuk ka pasur Dividendë të paguar.

2.3 Të dhëna për drejtorët jo-ekzekutiv

Anëtarët e Bordit të Drejtoresh të KMDK-se janë emëruar në bazë të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës

h-Emrat e drejtorëve të bordit gjatë vitit, duke përfshirë kompensimet, shpenzimet dhe pagesat për shërbimet e ndërmarrjes

Emri dhe Mbiemri	Pozita	Paga	Pjesëmarrje në Komitet
Asllan Vitaku	Kryesues Bordit	320	190

Bajram Limani	Anëtar	270	205
Makfire Osmani	Anëtarë	270	100
Isak Rakovica	Anëtar	270	110
Naim Ferati	Anëtar	270	100
Eset Rama	Anëtar	270	120

i-Numri takimeve të Bordit gjatë vitit dhe numri pjesëmarrjes së drejtorëve në takimet e bordit

Bordi Drejtoreve të KMDK-së, gjatë vitit 2012 ka mbajtur 11 mbledhje të rregullta dhe 2 mbledhje të jashtëzakonshme.

Asllan Vitaku, Bajram Limani dhe Isak Rakovica kane marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e Bordit gjatë vitit 2012.

Naim Ferati ka marrë pjesë në 11 mbledhje, Makfire Osmani në 11 mbledhje dhe Eset Rama në 9 mbledhje të Bordit gjatë vitit 2012 (Mungesat e anëtarëve të Bordit në mbledhje janë arsyetuar me Pushime vjetore, udhëtime zyrtare dhe angazhime në vendet primare të punës).

j-Komitetet e Bordit, përbërja e tyre dhe numri takimeve të mbajtur

Komiteti i Auditimi, përbërja:

Z. Eset Rama, Znj. Makfire Osmani, Z. Naim Ferati

Komiteti i Auditimit ka mbajtur 9 takime gjatë vitit 2012.

Komiteti për përafrimin e standardeve të Deponive Sanitare, përbërja:

Z. Isak Rakovica, Z. Bajram Limani, Z. Asllan Vitaku

Komiteti për përafrimin e standardeve të deponive sanitare ka mbajtur 10 takime, ku prej tyre 9 takime kane qene vizita në teren për vitin 2012.

Komiteti për Emergjencë, përbërja:

Z. Bajram Liman, Z. Asllan Vitaku, Z. Abdullah Haxhiu

Komiteti për Emergjencë, nga muaji shtator 2012. ka mbajtur 4 takime dhe ka pasur 3 vizita në teren.

2.4 Informacione tjera

Raportimet e nevojshme për Aksionarin

k-Sponsorimet dhe donacionet—Përveç Grandëve të dhëna nga Aksionari – shuma prej 143.191 euro, Qeveria e Republikës së Kosovës-MZHE , NP KMDK- nuk ka pas Sponsorime a Donacione tjera.

I- Raportet e auditorit të brendshëm

RAB 10.10.2012 Auditimi i pasqyrave financiare për muajin Prill –Qershor

RAB 20.10.2012 Auditimi i pasqyrave financiare Korrik- Shtator

RAB. 25.10.2012 Auditimi i pasqyrave financiare Janar –Shtator

RAB 15.11.2012 Auditimi i pasqyrave financiare muajin- Tetor

RAB 16..12.2012 Auditimi i pasqyrave financiare për muajin Nëntor

RAB 25.12.2012 Auditimi i asetëve të KMDK

Plani vjetor i Auditimit per vitin 2013


II-Raporti mbi vetëvlerësimin e bordit të drejtorëve – është pjese përbërëse e këtij raporti.

2.5 Raportimet sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike

m-Pasqyra e Strukturës organizative të NP, Organogrami dhe komentet

Struktura organizative në KMDK dhe Organogrami është konform kërkesave për funksionalizimin e ushtrimit të detyrave të parashtruara nëpër Deponitë sanitare, gjithë një duke u bazuar në Planin Aktual të Biznesit , mirëpo , me qëllim të ngritjes së shkallës së funksionalizimit të KMDK-së në përgjithësi, e në veçanti nëpër Deponitë Sanitare , është më se urgjentë të angazhohet një Inxhinier për makineri të rendë , gjersa mirëmbajtja e makinerisë së rendë nëpër Deponi të jetë Ekipore , duke qenë të angazhuar 3 Mekanikë (një për Prishtinë dhe Podujevë, një për Gjilan dhe Ferizaj dhe një për Prizren).

Ngritja e nivelit të disiplinës teknologjike për kryerjen e detyrave të punës, e cila për qellim ka ngritjen e azhuritëtit të punës se përditshme , duhej të jetë çështje primare për arritje të rezultateve më pozitive në KMDK- në të gjitha nivelet e detyrave dhe të përgjegjësive të të gjithë të punësuarve në Kompani.



n-Shqyrtimi performancës afaristë dhe financiare gjatë tremujorit Tetor-Dhjetor 2012.

Të dhënat e performancës dhe objektivat	Vlerësim I performancës Tetor – Dhjetor 2012	Projektimi i performances Tetor - Dhjetor2012
Numri i klientëve të rregullt	22	50
Mbeturinat e hedhura	46737	51810
Faturimi	€ 248,175	€ 275,097
Inkasimi	€ 297,425	€ 275,097
Të ardhurat jo operative grantët	€ 57,996	€ 358,000
Shpenzimet ne operim	€ 164,380	€ 242,060
Shpenzimet amortizimit	€ 255,334	€ 255,334
Llogaritë e arketueshme	€ 1.096.726	€ 625,004
Llogaritë e pagueshme	€ 570.370	€ 500,000
Paratë e gatshme dhe paratë ne banke	€ 19,677	€ 76,403
Numri i të punësuarve	46	51
Shkalla e inkasimit (total)	119.84%	100%
Norma e mbulimit me punë	1.80	1.01
Norma e punës	1.51	1.01
Tarifa mesatare	5.31	5.26
Shpenzimet operative për ton	€ 8.98	€ 6.45

Në periudhën Tetor – Dhjetor 2012 shkalla e inkasimit nga kompanitë regionale të mbeturinave dhe nga klientët e tjerë privat është 119.84%.

Norma e punës (Akruali i të ardhurave në operim/akruali i shpenzimeve operative) në periudhën Tetor – Dhjetor 2012 është 1.51

Norma e mbulimit të punës (të ardhurat e operimit në kesh/shpenzimet aktuale të operimit) në periudhën Tetor – Dhjetor 2012 është 1.80

Gjatë periudhës Tetor – Dhjetor 2012 shpenzimet operative / mbeturinat e hedhura për ton janë 8.98 euro, pra 39 % me të larta se sa që është planifikuar prej 6,45 euro.

nj- Përmbledhja e procedurave gjyqësore gjatë vitit 2012.

Gjatë vitit 2012, si kompani jemi ballafaquar me zhvillimin e procedurave gjyqësore në kontestet të cilat janë iniciuar nga disa prej ish-kontraktoreve tanë të cilët kanë ushtruar padi (propozime për përmbarim) ndaj KMDK SH.A, si dhe me disa konteste ku në si KMDK SH.A, kemi ushtruar ndaj ish-kontraktoreve tanë, poashtu kemi pasur edhe disa konteste ku ish-punëtorët tanë na kanë paditur pranë gjykatave kompetentë.

Me ish-kontraktorin **Alphenbau** jemi në proces gjyqësorë lidhur me borxhin që kemi ndaj tij, KMDK ka ushtruar ankesë në gjykatën supreme ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike dhe deri me tani nuk kemi ndonjë ftese nga gjykata. Me ish kontraktitorin **Getoari** i cili ka paditur kompaninë tone, kemi arritur një ujdë gjyqësorë dhe kjo çështje është mbyllur. Me ish-kontraktorin tjetër i cili na ka furnizuar me derivate të naftës "**Hib Petrol**" kemi pasur një kontest gjyqësor, ngase ka ushtruar një propozim për përmbarim ndaj KMDK SH.A për shumën e borxhit prej 100 mijë Euro, por edhe kjo çështje kontestuese është përmbyllur me ujdë gjyqësorë. Gjatë vitit 2012 kemi pranuar një propozim për përmbarim nga NNT "**KASTRIOTI**", ushtruar pranë Gjykatës Ekonomike në shumën e borxhit prej 86.815,44 euro me kamatë vjetor 3.5% ish- kontraktor i kompanisë sonë, në baze të aktgjykimit të Gjykatës Ekonomike të marre që në vitin 2008 dhe i cili është bere i plotfuqishëm në vitin 2012. Ky kontest ka ndikuar që të na bllokohet xhirollogaria e KMDK SH.A, nga e cila kemi pas shumë pasoja financiare deri sa kemi arrit ta paguajmë borxhin.

Ndërsa ne gjatë vitit 2012 kemi ushtruar padi pranë gjykatave kompetentë ndaj klientëve dhe ish-kontraktoreve tanë. Ndaj **KRM "Pastrimi"** për shumën e borxhit **1.408,392,89 Euro** jemi në proces e sipër, janë zhvilluar disa seanca, kemi prezantuar provat, gjykata ka kërkuar negociim mes palëve lidhur me riprogramimin e borxhit, mirëpo përfaqësuesit e KRM "**Pastrimi**" nuk kanë shprehur interesim dhe kanë kërkuar ekspertizë financiare për barazimin e borxheve, eksperti ka filluar punën dhe presim raportin e ekspertit si dhe ftësën nga Gjykata. Me **KRM "Ekoregjioni"** lidhur me kontestin për shumën e borxhit 535.334,84 Euro, kemi arritur marrëveshje dhe procesi ka përfunduar me Ujdë Gjyqësorë. Me **KRM "Higjiëna"** për shumën e borxhit 298.472,49 Euro, kemi arritur marrëveshje dhe procesi ka përfunduar me Ujdë Gjyqësorë. Ndaj **KRM "Pastërtia"** për shumën e borxhit 162.805,86 Euro, kemi parashtruar propozimin për përmbarim (padi) dhe presim zhvillimin e seancave. Gjykata Ekonomike ka aprovuar propozimet tona, por KRM-të kanë kundërshtuar përmes prapësimeve dhe lendet kanë kaluar në konteste civili sipas Ligjit të Proceduarës Kontestimore. Siç edhe u cek me lartë me disa prej klientëve tanë kemi arritur ujdë gjyqësorë ndërsa me disa tjerë jemi në proces. Ndaj **NTP Metali** ish-kontraktor i KMDK SH.A, kemi parashtruar padi në vlerë 155.524.00 € pranë Gjykatës Ekonomike lidhur me mospërmbushjen e kontratës për Riparimin e Motorit të Dressta, presim ftësën për seancën e radhës. Kemi pranuar një parashtrësë nga Gjykata si dhe përgjigjen në padi si dhe aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike ndaj të cilit kemi ushtruar ankesë në Gjykatën Supreme. Ndaj **N.P.N "Vizion Project"** ish-kontraktor i KMDK SH.A, kemi parashtruar padinë në vlerë 26.887.05 € pranë Gjykatës Ekonomike lidhur me mospërmbushjen e kontratës për **Trajtimin e Ujërave të zeza**, janë mbajtur disa seanca dhe janë shtruar disa parashtrësë në padi, presim ftësën për seancën e radhës. Poashtu kemi edhe një kontest lidhur me aksidentin që ka ndodhur në DS Gjilan në vitin 2010, siç edhe jeni të njohur ky kontest ka të beje me **kompensimin e demit material dhe jo material**, me kërkesën e palëve është vendosur të behën dy ekspertiza, pas raportit të ekspertëve ne kemi

zhvilluar një seance dhe kemi kundërshtuar ato raporte të ekspertëve si dhe kemi paraqitur fjalën përfundimtare. Presim vendimin e Gjykatës.

Sa i përket kontesteve gjyqësore të iniciuara nga ish-punëtorët tanë, kemi pasur një rast të kontestit të punës në **Gjykata Komunale** për rastin e largimit nga puna të ish-punëtorit **Z. Hashim Dragusha**, por ky rast është përmbyllur me një ujdë gjyqësore dhe Z. Dragusha është kthyer në pune. Ndërsa në rastin e padisë së **Z. Avni Ramdani** lidhur me largimin e tij nga puna, ne si kompani kemi ushtruar një përgjigje në padinë e këtij të fundit dhe akoma nuk kemi ndonjë ftësë nga gjykata. **Rasti i një kontesti të një punëtori tjetër të KMDK SH.A**, i cili na ka paditur për konflikt administrativ, ndaj këtyre ankesave dhe aktvendimeve të Gjykatës Supreme kemi ushtruar përgjigje në padi dhe ankesa, akoma nuk kemi ndonjë ftese apo njoftim tjetër. Një proces tjetër gjyqësor është zhvilluar në Gjykatën Komunale për Kundërvajtje lidhur me trajtimin e mbeturinave në DS Mirash, kemi mbajtur një seancë për këtë rast dhe kemi paraqitur argumentet tona, deri tani nuk kemi marre ndonjë ftese tjetër.

o-Përmbledhja e procedurave gjyqësore për 2013

Kemi iniciuar një propozim për përmbarrim (padi) ndaj KRM “**ÇABRATI**”, por kemi arritur një marrëveshje jashtë gjyqësore dhe është përmbyllur kjo lende. Një rast tjetër që kemi në zhvillim e sipër është një propozim për përmbarrim (padi), të cilën e ka ushtruar Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM), ndaj KMDK SH.A, për taksën vjetore për licence, ne kemi kundërshtuar këtë propozim por pa dashur të paragjykojmë ka rrezik potencial që Gjykata të vendos në favor të ZRRUM dhe të na bllokohet xhirollogaria.

Në rast se ndonjëri nga klientët tanë apo edhe kontraktoret nuk u përmbahen obligimeve ndaj neve bazuar në kontratat që kemi, mund të kërkojmë që këto obligime të realizohen përmes procedurave gjyqësore.

p-Transaksionet e konsiderueshme që përfshin NP

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë KMDK SH.A ka xhirollogarinë kryesore në:

Procredit Bankë me numër 1110-2060-89-0001-81

Xhirollogarinë për donacione me numër 1110-2060-89-0001-71

Xhirollogarinë për subvencion me numër 1110-206089-0001-20

q-Sugjerime dhe propozime për ndryshime të cilat me arsye pritët që ta rrisin performancën e NP

NP KMDK ka nevojë për një Qasje më aktive dhe në vazhdimësi - në nivele të duhura të mikromenaxhmentit pothuajse për të gjithë sektorët e menaxhmentit (operativa, financat, prokurimi dhe auditimi), duke potencuar nivelin e duhur profesional për punët e operativës neper deponi, në veçanti të Profesionistëve për Mirëmbajtje të planifikuar të Makinerisë së rendë, marrë parasysh numrin e defekteve dhe mirëmbajtjen e mangët dhe shpeshherë jo efikase të makinerisë së rendë gjatë vitit, gjë e cila ndikon drejtpërdrejt në efikasitetin e menaxhimit të mbeturinave neper deponi dhe e cila do të ndikonte që të zvogëlohen edhe me tepër shpenzimet operative të mbeturinave. Kjo e gjithë padyshim do e avanconte qasjen e menaxhimit me të rregullte të mbeturinave , në rend të pare duke kompaktuar dhe mbuluar me dhe me tepër hapësira të mbeturinave neper deponi. Stafit lartë menxherial- ai për financa, auditim dhe posaçërisht për prokurim, ka nevojë për trajnime specifike, brenda dhe jashtë vendit , marre parasysh se ZL i financave, ai i auditimit dhe me gjasa edhe të prokurimit, janë Zyrtare me përvojë të shkurtë në KMDK.

rendë, marrë parasysh numrin e defekteve dhe mirëmbajtjen e mangët dhe shpeshherë jo efektive të makinerisë së rendë gjatë vitit, gjë e cila ndikon drejtpërdrejt në efikasitetin e menaxhimit të mbeturinave neper deponi dhe e cila do të ndikonte që të zvogëlohen edhe me tepër shpenzimet operative të mbeturinave. Kjo e gjithë padyshim do e avancojë qasjen e menaxhimit me të rregullte të mbeturinave , në rend të parë duke kompaktuar dhe mbuluar me dhe me tepër hapësira të mbeturinave neper deponi.

Stafi lartë menxherial- ai për financa, auditim dhe posaçërisht për prokurim, ka nevojë për trajnime specifike, brenda dhe jashtë vendit , marrë parasysh se ZL i financave, ai i auditimit dhe me gjasa edhe të prokurimit, janë Zyrtare me përvojë të shkurtë në KMDK.

Në nivel të Bordit është më se e nevojshme të formohet Komiteti Profesional për Investime kapitale dhe Zhvillim, me qëllim që Investimet e realizuara të jenë konform parametrave teknik të projektuar dhe që mbikëqyrjen dhe pranimin teknik të punëve lidhur me Projektet ta ushtrojnë ekspertët e lëmive gjegjëse.

Gjatë vitit 2013, do duhej që Aktivitetet për Aplikim të Partneritetit Publiko-Privat të jene me intensive, marrë parasysh mundësinë e trajtimit dhe të riciklimit të mbeturinave. Dhe kjo do mund të realizohet në bashkëpunim me Sektorin privat , duke vendosur se paku dy Qendra të riciklimit të mbeturinave në Deponitë e Gjilanit, Podujevës dhe pse jo edhe të Prizrenit. Kjo padyshim se do përshpejtonte fazën e ardhshme dhe të domosdoshme, që Sektori Menaxhimit të mbeturinave tërë të kalojë në Prone privatë. Për këtë Menaxhmenti planifikon një vizitë në Istanbul-Turqi , ku do kishim parë për se afërmi përvojën e Komunave të kësaj Qendre grandioze me mbi 17 milion banorë.

Kryesues i BD të KMDK SH.A
ASLLAN VITKAU



15/03/2013

3. Raporti i Zyrtarit Kryesor Ekzekutiv

HYRJE

Në cilësinë e Kryeshefit Ekzekutiv paraqesë raportin e përfundimtarë për vitin 2012 të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A. Pasi që viti 2012 për mua si KE ishte një vit sfidues, për të menaxhuar një kompani e cila kishte problem të mëdha financiar dhe operative të trashëguara dhe të bartura prej një viti në vitin tjetër. Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A (KMDK SH.A) është kompania e vetme si autoritet përgjegjës e legalizuar dhe licencuar për menaxhimin e deponive sanitare regjionale të mbeturinave Komunale në Republikën e Kosovës, e koorporatizuar dhe plotësisht e regjistruar si shoqëri aksionare sipas Ligjit mbi Shoqëritë Tregtare Nr. 02/L-123.

Duke pasur parasysh natyrën që kanë shërbimet në deponimin e mbeturinave të amvisërisë komunale, roli i KMDK SH.A, është esencial në parandalimin e ndotjes së Mjedisit. Kompania ka pasur kujdes që ky potencial i shërbimeve mos të keqpërdoret, por që të ndikoj në stimulimin e efijencës ekonomike dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për konsumatorët e këtyre shërbimeve. Këtë rol KMDK SH.A e ushtron duke u mbështetur në legjislacionin në fuqi dhe mekanizmat tjerë rregullues.

1. Ngjarjet kryesore të vitit
2. Pasqyre të performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performances
3. Pasqyre të performancës financiare dhe rezultatet
4. Progresi me planin e biznesit
5. Shpenzimet kapitale dhe projekteve
6. Perspektiva për vitin e ardhshëm
7. Rreziqet e të ardhmes së korporatës

3.1. Ngjarjet kryesore të vitit

Unë si KE dhe i gjithë stafin e kompanisë, duke u mbështetur edhe në politikat e BD, jemi angazhuar me të gjithë potencialin tonë intelektual dhe fizik, që të tejkalojmë vështirësitë financiare dhe operative. Një rëndësi të veçantë i kemi kushtuar përfundimit të projekteve të nisura, me përfundimin e këtyre projekteve do të krijohen kushte më të mira në ngritjen e nivelit të shërbimeve dhe sigurisë më të madhe në ruajtjen e mjedisit. Gjithashtu i kemi kushtuar rëndësi operativës dhe operimit nëpër deponise sanitare të cilat janë bërthama më e rëndësishme e qëndrueshmërisë financiare të kompanisë dhe ngritjes së nivelit të cilësisë së shërbimeve për interes të qytetarëve, zhvillimit ekonomik dhe të ndikimeve sociale.

Ngjarjet që duhet veçuar këtë vit janë:

- Arritja e marrëveshjeve me tre KRM për riprogramimin e borxheve, me dy prej tyre kemi përfunduar kontestet me ujdj gjyqësore (KRM “Higjiena” dhe KRM “Ekoregjioni”) dhe me një marrëveshje jashtë gjyqësore me (KRM Çabrati) ;
- Investimet në infrastrukturë nëpër deponite sanitare regjionale;
- Investimet në makinerinë e rëndë, kryesisht në riparimin e tyre;
- Investimet në trajtimin e ujërave të zeza;

- Inicimi i padive ndaj KRM-ve dhe disa OE privat për obligimet që kanë ndaj KMDK SH.A;
- Inicimi i padive gjyqësore të OE ndaj KMDK-ës, me një rast e kemi pas xhirollogarinë e bllokuar me vendim të Gjykatës Ekonomike

Aktivitete kryesore të kompanisë janë zhvilluar në nëpër Deponie Sanitare Regjionale, në trajtimin e një fluksi të madh të mbeturinave, (hedhja, kompaktimi, si dhe mbulimi i tyre pjesërisht) përkundër vështirësive të mëdha të cilat është përballur kompania nga mos inkasimi i borxheve nga KRM-te. Me një makineria e cila ka qenë totalisht e amortizuar, kemi bërë përpjekje maksimale në riaftësimin e tyre, me qëllim që mos të pengohet procesi i punës dhe të operohet në deponite sanitare sipas standardeve gjeneralë në trajtimin e mbeturinave. Në fokus të aktiviteteve të kompanisë kanë qenë respektimi i procedurave financiare dhe të prokurimit, me qëllim të realizimit, të projekteve të mbështetura përmes grandëve qeveritare dhe nga të hyrat vetanake.

3.2. Pasqyre të performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performances

Me angazhimin e stafit menaxherial dhe gjithë punonjësve të kompanisë, jemi përpjekur që këtë vit sado pak të kemi afarizëm më të mira financiar dhe performancë më të mirë operative. Besojmë shumë se në vitin 2012 ja kemi arritur këtij qëllimi, e që mund të vërehet duke i përfshirë aktivitetet të shtuara operative nëpër Deponite Sanitare Regjionale, në trajtimin e një fluksi të madh të mbeturinave të grumbulluara me vite, (zhvendosja, kompaktimi, si dhe mbulimi i tyre pjesërisht) përkundër vështirësive të mëdha të cilat është përballur kompania nga mos inkasimi i borxheve nga na e KRM-ve. Kemi arritur që të riaftësojmë makinerinë e cila ka qenë totalisht e amortizuar, është aftësuar Dressta e cila ka qenë defekte pas përmbytjes së saj e cila ka ndodhur në vitin 2011 në DS- Mirash, është aftësuar Bomagu i cili ka qenë defekte gjatë viti 2011, po ashtu është bërë intervenimi apo rifreskimi i motorit të amortizuar të Fiat Hitachi në DS- Gjilan , në DS- Prizren si dhe DS- Podujevë, rifreskimi i këtyre motorëve ka rritur jetëgjatësinë e tyre. Gjatë vitit 2012 KMDK-ja i ka kushtuar rëndësi të madhe ruajtjes së mjedisit, përmes planit operativë ka arritur ti ndal zjarret në deponinë e Gjilanit, si dhe ka bërë mbulimin e mbeturinave me sasi dheu 65 % të sipërfaqes. Në DS- Prizren është finalizuar projekti i lagunës i cili ka mbetur në gjysmë gjatë viti 2011, me aktivizimin e kësaj lagune ka rritur ti ndal rrjedhjet e ujërave të zeza në këtë deponi, si dhe mbajtjen nën kontroll të nivelit të ujërave të zeza të lagunave në DS- Gjilan dhe DS- Podujevë, këto aktivitete kanë rritur performancën operative në vitin 2012 duke arritur progres në ruajtjen e mjedisit, krahasuar me vitin e kaluar.

Një pasqyrë më e mirë e të arriturave dhe ngritjes së performances së kompanisë mund të vërehen nga indikatorët e paraqitur si më poshtë:

- **Uljen e shpenzimeve,**
- **Ngritja e nivelit të inkasimit,**
- **Avancimi i sistemit të operimit të Deponive sanitare regjionale,**
- **Përfundimi i projekteve të parapara sipas planit të biznesit.**
- **Respektimi i rekomandimeve të dala nga raporti i Zyrës së Auditorit Gjeneral**

Këto prioritetet janë edhe indikatorët kryesor të kompanisë në vlerësimin e performances

- a) Përforcimi i kontrolles - mund të vërehet me efektet në realizimin e norme së punës, uljes së shpenzimeve. Këto komponentë kanë ndikuar në ngritjen e nivelit të cilësisë së shërbimeve dhe ruajtjen e kredibilitetit të kompanisë;

- b) Avancimi i sistemit të operimit duke i rifunksionalizuar asetet e dëmtuara në Deponit Sanitare Regjionale, me qëllim të ngritjes së cilësisë së punëve dhe shërbimeve;
- c) Ngritja e nivelit të Arkëtimit (inkasimit), gjithashtu mund të vërehet me rritjen për mbi **22%** krahasuar me vitin paraprak, kjo ka ndikuar në forcimin e qëndrueshmërisë financiare të Kompanisë;
- d) Bashkëpunimi me palët e interesit, me qëllim krijimit të raporteve bashkëpunuese ndërinstitucionale duke respektuar çdoherë kornizën ligjore, në përmbushjen e obligimeve për të pasur një sektorë të qëndrueshëm në menaxhimin e deponimit të mbeturinave sanitare në Kosovë.
- e) Kontaktimi i institucioneve financiare ndërkombëtare, me qëllim të përfitimit të mbështetjes së projekteve të KMDK-ës.

a). Në përforcimin e kontrolles, janë krijuar trupa të cilat merren me kontrollimin dhe mbikëqyrjen e punës në deponite sanitare dhe administratë, kemi nxjerr vendime dhe urdhëresa pune, me qëllim që ky proces të monitorohet sa më mirë. Gjatë kësaj periudhe duke aplikuar edhe vetë kontrollin, janë marrë masa të caktuara disiplinore të cilat besojmë se kanë dhënë efekte pozitive në vetëdijesimin e punonjësve që të jenë më të përgjegjshëm në kryerjen e detyrave.

b). Një rëndësi tjetër i është kushtuar ngritjen e vlerës së asetëve tjera, me angazhimin tim, kemi arritur me angazhuar KEK- njësinë në Gjilan, që në DS të Gjilanit të kyçim rrymën në sistemin e pompave për riqarkullimin e ujërave të zeza. Gjatë kohës së punës me naftë, këto pompa kanë harxhuar në baza mujor mesatarisht 3000 litër naftë. Gjithashtu me angazhimin time, në rastet kur kemi pasur vështirësi të operimit me makinerinë tonë, kam arritur të gjejë mbështetje nga KEK, në shtyrjen e mbeturinave në DS të Mirashit. Gjatë këtij viti jemi pajisur me një makineri të rënd Kamatsu për shtyrje të mbeturinave dhe rimorkio për bartje, këto janë marrë nga KRM Ekoregjioni si kompensim për borxhin që ka kompania në fjalë ndaj KMDK-se, gjithashtu këtë vit janë riparuar katër makineri të rënda, të cilat kanë rritë shpenzimet e kompanisë dhe koston e operimit.

c). Shkalla e Arkëtimit (Inkasimi), për vitin 2012 krahasuar me e vitin e kaluar 2011 kemi pasur një rritje të inkasimit për **22%**

Indikatorët kryesor të kompanisë të cilat janë të rëndësishme dhe bëhet vlerësimi i performances së kompanie.

- Shkalla e Inkasimit (€) **84%**
- Ulje të shpenzimet totale (€/t) **21%**
- Norma e mbulimit me punë **0.92%**
- Norma e Punës, **1.12**

d). Bashkëpunimi me palët e interesit.

Kemi bashkëpunuar me **Institucionet shtetërore te dy niveleve**, (qendror dhe atë lokal). Nga **niveli qendror**, (Ministra, zëvendësministra ,këshilltar ,sekretar, drejtor, inspektor e zyrtare tjerë. Nga **niveli lokal**, (Kryetar Komunash, Nënkyetar Komunash, Drejtor të Drejtorateve, Inspektor dhe zyrtar tjerë.

Kompanitë regjionale, klientëve me te cilat kemi raporte afariste dhe kompani jo klientële e jona, me të cilat nuk kemi raporte afariste, por që kemi shkëmbyer përvoja te ndërsjella. Përfaqësimi i kompanive ne takime është bërë nga. Kryesues dhe anëtar te Bordeve te Kompanive respektive. Kryeshefat Ekzekutiv, Drejtor dhe përfaqësues tjerë te këtyre kompanive. Kemi pas fryme bashkëpunimi dhe kemi qenë të hapur për të gjitha mediet e

interesuar elektronike dhe te shkruara. Institucione te pavarura vendore e ndërkombëtare si, Obduspersonin dhe këshilltaret e tij, BU&Partneres, Ecovision, "KUR"Prishtina, KFOR, JICA, USAID, përfaqësues te shoqërisë civile ,etj

e). Kontaktimi i institucioneve financiare ndërkombëtare, siç është Banka Botërore, JIAC-Japonisë,USAID etj.

3.2.1. Gjendja operative në deponite sanitare të KMDK-se

Deponinë Sanitare në "Mirashit" Prishtinë, në fillim te vitit kanë qenë një gjendje e rende operative për arsye të kushteve mjaftë të renda atmosferike. Kjo situatë është krijuar edhe për arsye se që nga viti 2011 makineria me të cilën është dashtë të punohet ka qenë në defekt. Brenda një periudhe të shkurtër kemi arrit që ti aftësojmë këto makineri dhe të përmirësojmë operimin në këtë DS dhe kemi krijuar kusht më të mira infrastrukturore për klientët që sjellin mbeturina ne këtë deponi.

Për këtë DS ka pasur një studim nga IFC qyshe në Tetor të viti 2010 dhe janë rekomanduar hapat qe duhet ndërmarrë për të përmirësuar qëndrueshmërinë e kësaj deponie. Ne si kompani për arsye të vështirësive financiare nuk kemi mund të investojmë në këtë DS, gjithashtu nuk kemi gjetur as mbështetje institucionale, që të fillohet me aktivitet sipas rekomandimeve të IFC. Kjo DS paraqet rrezik permanent për mjedisin, rrezikim i aseteve shtetërore, por rreziku më i madh është se mundë të vije deri të rrezikimi i shëndetit dhe të humbja e jetës së njerëzve në atë mjedis. Për të dalë nga kjo situatë jo vetëm angazhimi i ynë do të jetë i mjaftueshëm, por duhet angazhuar të gjitha palët e interesit shoqërorë.

Deponia Sanitare regjionale "Velekincë" Gjilanë, në këtë DS qe nga viti 2011, ka pasur përfshirje masive të zjarrit në trupin e deponisë në vazhdimësi, rreth gjendjes së kësaj deponie është i informuar mbarë opinioni jo vetëm kosovarë.

Gjatë vitit 2012 kemi ndërmarrë veprimet konkrete ne parandalimin e zjarrit, pasi që në këtë deponi nuk kemi pasur asnjë makineri funksionale. Për të mos ardhur deri të rrezikimi i tërë deponisë dhe dëmeve të paparashikuara për mjedisin dhe ambientin, përmes procedurave të prokurimit kemi angazhuar OE privat dhe pas një periudhe të shkurtër kemi shuar në tërësi zjarrin dhe kemi filluar ti mbulojmë mbeturinat dhe krijuar kushte mjaftë të mira operative dhe infrastrukturore, gjithashtu ujërat e zeza janë në kontroll. Për arsye të trajtimit të më hershëm jo profesional të mbeturinave dhe mos funksionimit të sistemit të ajrosjes dhe gazifikimit, kohë pas kohe mund të paraqiten zjarret në këtë deponi, zjarret mund të shkaktohen edhe nga personat e paautorizuar që hyjnë në deponi për të mbledhur mbeturina.

Stacioni i Transferit (ST)të mbeturinave Ferizaj, gjendje në këtë ST ka qene para kolapsi, vetëm kamioni transportues "IVECO" dhe ai jo me kapacitet të plotë. Nga grumbullimi masivë i mbeturinave ka pas prodhim të shtuar të ujërave të zeza të cilat kanë dal jashtë kornizës së ST. Me investimin që kemi bërë në rregullimin dhe riaftësimin e makinerisë dhe investimit në infrastrukture, me ndërtimin e kolektorit kemi eliminuar problemin e ujërave të zeza.

Deponia Sanitare regjionale e"Landovices"Prizren, kjo deponi ka qenë më stabile edhe pse për një kohë të gjatë është punuar vetëm me BOMAG, i cili në një masë ka dëmtuar një pjesë të infrastrukturës së deponisë. Në këtë deponi përmes ndihmës-grandit qeveritarë kemi investuar në infrastrukturën e trajtimit të ujërave të zeza, kemi ndërtuar lagunën e re e cila nuk ka qenë në tersi e përfunduar. Pjesa e shtrimit të gjeofolise nuk ka mund të përfundohet derisa të përmirësohen kushtet atmosferike, atëherë do të finalizohet i tërë projekti dhe kështu përfundimisht më nuk do të ketë rrezik të derdhjes së ujërave të zeza në lumin e fshatit Landovicë.

Deponia Sanitare “Dumnic” Podujevë, që nga koha kur në këtë deponi kanë operuar OE privat kemi pas mbeturina të hedhura dhe të shpërndara në formë të pa kontrolluar dhe pa kurrfarë sistemimi nëpër të gjithë sektorët. Gjatë vitit 2012 kemi bërë një sistemim më të mirë të këtyre mbeturinave dhe kemi krijuar hapësirë dhe kushte më të mira për klientët tanë. Kjo shpërndarje e mbeturinave nëpër të gjithë sektorët, mund të ndikojnë në derdhjen e ujërave të zeza në lumin e fshatit, mirëpo deri më sot janë duke u mbajtur nën kontroll.

Vërejtje: Një rrezik permanentë për punonjësit dhe rrethinën është vendosja e kontejnerit me mbetje të pesticideve (7200L) i cili është sjellë nga MMPH gjatë vitit 2006 dhe ende është në deponi.

3.3. Pasqyre të performancës financiare dhe rezultatet

Nga raportimet e tremujorëve mund të vëreni se deri në përmbylljen e vitit, pas çdo tremujori kemi pasur **progres financiar dhe operativ**. **Progresi financiar** konsiston se përveç ngritjes së shkallës së inkasimit, uljes së shpenzimeve, kemi arritur që nga pesë Kompanitë Regjionale të Mbeturinave, me tri prej tyre të bëjmë Marrëveshje të Riprogaramimit të borxhit të vjetër, për realizimin e dy marrëveshjeve me Ujdi Gjyqësore garantues është Gjykata Ekonomike (tani Themelore). Këto marrëveshje kanë përmirësuar dukshëm performancën financiare dhe është ngrit fuqia kapitale në kryerjen e obligimeve ditore, mujore, vjetore dhe kryerjes së obligimeve të krijuara nder vite ndaj OE të kontraktuar.

Përmirësimi i performancës financiare, ka pasuar ndikim të drejtpërdrejt në përmirësimin e performancës operative në administrimin e mbeturinave në deponite sanitare. Përmirësimi i performancës operative mund të vërehet në të gjitha deponite sanitare dhe në stacionin e transferit, si në trajtim të mbeturinave dhe mbajtjes në kontroll të ujërave të zeza.

Kemi pasur edhe **progres operativ**, duhet veçuar investimet e bëra në Deponite Sanitare në Gjilan, DS në Prizren dhe DS në Prishtinë. Përmirësimet kanë ndodhë sidomos në periudhën e gjashtëmujorit të dytë pas investimeve që janë bërë në infrastrukturë, sidomos në deponine e sanitare në Prizren dhe Gjilan. Secili prej nesh, në ti përkujtoj pamjet e shfaqura nëpër media elektronike dhe të shkruara, ku në DS të Gjilan ka pas përfshirje masive të zjarrit. Një ndihmesë të theksuar në investimet e bëra në infrastrukturë e ka dhënë edhe MZHE përmes grandëve dhe subvencioneve. Duhet cekur se tre marrëveshjet për riprogramim të borxheve me KRM EcoHigjiena, KRM EcoRegjionin dhe KRM Çabrati, kanë ndikuar dukshëm që kompania të jetë më funksionale, si në aspektin financiar edhe në atë operativ. NE jemi të bindur se KMDK SH.A, për rastet tjera të iniciuara në Gjykatën Ekonomike (tash Themelore) ndaj klientëve tjerë do të dal fituese.

Të dhënat krahasuese me vitin e kaluar

Të dhënat e performancës dhe objektivat	2012	2011
Numri i klientëve të rregullt	22	45
Mbeturinat e hedhura	195,729	205,727
Faturimi	€ 1,034,106	€ 1,082,122
Inkasimi	€ 865,360	€ 669,491

Grandët	€ 143,191	€ 344,403
Shpenzimet ne operim , (p.sh amortizimi)	€ 1,021,350	€ 1,021,336
Shpenzimet e investimeve	€ 67,175	€ 58,000
Shpenzimet operative	€ 888,406	€ 1,076,795 ⁴
Llogaritë e arkëtueshme	€ 2,704,105	€ 934,245
Llogaritë e pagueshme	€ 570,370	€ 610,618
Paratë e gatshme dhe paratë ne banke	€ 20,206	€ 10,018
Numri i të punësuarve	51	46
Rritja e numrit të klientëve		
Shkalla e inkasimit (total)	84%	62%
Norma e mbulimit me punë	0.97	0.62
Norma e punës	1.16	1.06
Tarifa mesatare	5.31	5.26
Shpenzimet operative për ton	€ 9.86	€ 10.19

Përkushtimi i menaxhmentit dhe personelit të KMDK-ës është në ofrimin e shërbimeve sa më cilësore, sipas standardeve gjeneralë, përmes shërbimeve të rrisim vlerën e kompanisë.

Gjatë vitit 2012 KMDK ka pas ulje të faturimit për 5 % në krahasim me vitin 2011 dhe ulje të sasisë të mbeturinave. Rënia e faturimit ka qene si rezultat i masave administrative qe kemi ndërmarre ndaj KRM-ve pasi të njëjti nuk kanë kryer obligimet financiare ndaj nesh. Prandaj për një periudhe kohore ata nuk kanë sjellë mbeturina në deponite tona, por i kanë hedhur neper ambiente të hapura duke vepruar në dem të mjedisit. KRM Pastërtia mbi 3(tre) muaj i ka dërguar mbeturinat në një qendër Ricikluese të një operator privat “KARKO”, pastaj KRM Çabaratit nga muaji Dhjetor mbeturinat është duke i dërguar në Deponine e Pejës. Ne disa komuna është filluar me ndarje të mbeturinave nga individ dhe kompani qofte në mënyre të organizuar apo individuale edhe pse për këtë veprim nuk e besojmë se kane të drejt ligjore, me pastaj këto mbeturina transportohen jashtë vendi.

⁴ Shpenzimet operative të vitit 2011 kanë qene 1.076.795 Euro, duke përfshire edhe lejimin e borxheve të këqija në vlere prej 346.961 Euro. Shpenzimet për ton ka ndalur të jene 10.19 Euro e jo 8.51 siç është raportuar në raportin e vitin 2011. Ky ndryshim ka ardhur si rezultat i mos përfshirjes së borxheve të këqija të rekomanduara nga Raporti i Auditorit të Jashtëm.

Inkasimi për vitin 2012 është ngrit për 22 % në krahasim me vitin 2011.

Shpenzimet operative kanë pasura ulje për vitin 2012 për 21 % në krahasim me vitin paraprak 2011 si indikator i uljes së shpenzimeve janë lejitmet për borxhet e këqija dhe te dyshimta. Llogarite e pagueshme kemi ulje për 7 % në krahasim të vitit 2011 – si indikator është shlyerja e obligimit ndaj operatorit ekonomik Kastrioti.

Shpenzimet operative për ton të vitit 2012 është 9.86 € - në krahasim me vitin 2011 shpenzimet operative për ton është 10.19 €- si indikator është sasia e mbeturinave dhe faturimit.

Të dhënat nga Pasqyra e të ardhurave paraqesin performancën e KMDK-së gjatë vitit 2012 me zërat e të hyrave dhe shpenzimeve të njohura në baza akruale, sipas Standardeve të Kontabilitetit. Të hyrat nga faturimi për vitin 2012 kanë shënuar një ulje prej 48,016 € në krahasim me vitin 2011. Grandët e njohura si të hyra për vitin 2012 janë vlerë 143,191 €.

3.4. Progresi me planin e biznesit

Kemi pasur edhe **progres operativ**, duhet veçuar investimet e bëra në Deponite Sanitare në Gjilan, DS në Prizren dhe DS në Prishtinë. Përmirësimet kanë ndodhë sidomos në periudhën e gjashtëmujorit të dytë, pas investimeve që janë bërë në infrastrukturë, sidomos në deponine e sanitare në Prizren dhe Gjilan. Secili prej nesh, në ti përkujtoj pamjet e shfaqura nëpër media elektronike dhe të shkruara, ku në DS të Gjilan ka pas përfshirje masive të zjarrit. Një ndihmesë të theksuar në investimet e bëra në infrastrukturë e ka dhënë edhe MZHE përmes grandëve dhe subvencioneve. Prioriteti i kompanisë për vitin 2012 ka qenë përmirësimi dhe avancimi i operimit, duke u bazuar në standardet gjeneralë të DS. Operimi është një hap i rëndësishëm në ngritjen e qëndrueshmërisë financiare të kompanisë. Këtë vit mund të vërehet një progres sipas planit të biznesit në duke i krahasuar parametrat si më poshtë:

KMDK ka synuar i që realizimi i inkasimit të jetë 100% ndërsa KMDK ka realizuar inkasim vetëm 84% - si indikator i performances negative në realizimin e planit të biznesit për këtë pike janë mospagesa e borxheve të KRM dhe mosrespektimi i Marrëveshjeve të KRM dhe KMDK.

KMDK ka planifikuar që për vitin 2012 të ketë grande nga Buxheti i Kosovës në vlerë 358,000 euro, por për shkak të shkurtimit të mjeteve buxhetore nga Qeveria e Kosovës kemi realizuar vetëm 143.191.⁰⁰ euro.

Shpenzime operative kanë rezultuar të jenë më të ulëta për 23% në krahasim me të planifikuar, në planifikim të vitit 2012 ka qenë edhe pagesa e borxheve ndaj furnitorëve- në mungesë të mjeteve për KMDK ka qenë e pamundur të kryhen obligimet ndaj furnitorëve edhe pse janë zvogëluar për 7% me krahasim me vitin 2011.

Llogarit e arkëtueshme janë paraqit është lejimi i provizionimit të borxheve të këqija të cilat kërkohen me standarde të kontabilitetit- ky është indikator i diferencës të realizimit 2012 në krahasim me planifikim të 2011.

Shpenzimet operative për ton të vitit 2012 është 9.86 € - në krahasim me planifikim 2012 shpenzimet operative për ton të vitit 2012 8.51 €- si indikator është amortizimi i asteve.

Uljen e shpenzimeve, 21%

Ngritja e nivelit të inkasimit, 22 %

Avancimi i sistemit të operimit të Deponive sanitare regjionale, (rregullimi i rrugëve, rregullimi i pikave të zbrazjes duke krijuar kushte me të mira për klient)

Përfundimi i projekteve të parapara sipas planit të biznesit (Investimi ne infrastrukturë, përfundimi i Lagunës për trajtim të ujerave të zeza në Prizren, përfundimi i punimeve dhe vendosja e Peshores Elektronike në Mirash.)

3.5. Shpenzimet kapitale dhe projekteve

Investimet kapitale kanë treguar performancë operative në krahasim me vitin paraprak 2011, me këto projektet është finalizuar projekti i trajtimit të ujërave të zeza në DS- Prizren , duke eliminuar në tërësi rrjedhjen e ujërave të zeza nga laguna dhe në pjesën jashtë trupit të DS aty ku janë përzier ujërat e bardha me të zeza, është intervenuar në pusët dhe këta ujëra janë orientuar në lagunë . Në lagunën e vjetër ekzistuese në DS- Prizren është rregulluar një pjesë e vogël e gjeomembranës e cila ka qenë e dëmtuar , të gjitha këto aktivitete janë kryer përmes investimeve kapitale dhe kanë ndikuar në ruajtjen e mjedisit. Është siguruar skarpate në pjesën e poshtme të trupi të DS- Landovicë e cila është rrezikuar nga shembja e cila mund të shkaktonte pasoja katastrofale për ambientin, ky problem është evituar, janë vendosur gabionet të cilët janë mbushur me gurë dhe janë përforcuar me rrjeta metalike, pastaj janë mbushur me argjilë, është mbjellura me vegetacion, rregullimi i sistemit të drenazhimit në DS- Mirash, Prizren, Gjilan, përmirësimin e kushteve për punëtor, janë vendosur rrethojat në DS- Prizren , betonuar kanalet e hapura në formë trapezi për largimin e ujërave të bardha atmosferike nga trupi i DS etj. Gjatë viti 2012 KMDK-ja ka arritur progres përmes investimeve kapitale në rregullimin e infrastrukturës rrugore me zhavorr fra IV në DS- Mirash , DS- Gjilan , DS- Prizren duke krijuar qasje të mirë në DS të subjekteve të cilit sjellin mbeturina, duke ulur koston operative në raport me orët punuese të makinerisë dhe zvogëluar distancën e shtyrjes së mbeturinave në sektorin e përcaktuar përmes administrimit të mbeturinave .

- Rregullimet e rrugëve, si dhe pikat e zbrazjes duke krijuar kushte ma të mira për klient,
- Përfundimi i projektit të Lagunës së ujërave të zeza në DS në Prizren,
- Rregullimi i Peshores/urës matëse elektronike në DS-Mirash-Prishtinë.
- Rregullimin e Pompave nëpër DS si dhe aktivizimin e tyre,
- Zbrazjen e Lagunave nga ujërat e zeza ekzistuese,
- Blerjen e pjesëve rezervë të makinerie së rëndë dhe riparimi i tyre ,
- Rregullimin e kushteve për punëtor.
- Blerjen e një makineri Kamatsu për shtyrje të mbeturinave dhe rimorkios për bartje të makinerisë,

Rregullimi i infrastrukturës se brendshme dhe të jashtme të deponive etj

Investimet nga Grandet e MZHE-së	Vlera
1. Rregullimi i Infrastrukturës neper deponite regjionale te ujerave te zeza të KMDK-se	57.995,00 €
2. Obligime ndaj furnitorit Kastrioti për shërbimet e kryera	30,000.00 €
3. Subvencionim për derivate te naftës për KMDK-ne,vlera	55,196.00 €
Gjithsejthe vlera e grandeve:	143,191,00 €

Vonesa administrative nuk ka pasur, vonesa në prokurim ka pasur pasi është anuluar tenderi njëherë , ndryshim të kostos në implementimin e projektit nuk ka pasur.

3.6. Perspektiva për vitin e ardhshëm

Në fokus të angazhimeve të KMDK-së edhe për vitin e ardhshëm do të jetë përmirësimi dhe rregullimin e infrastrukturës, blerja e makinerisë për DS dhe ofrimi i kushteve ma të mira për Klientët tanë dhe lidhja e kontratave dhe marrëveshjeve me Klientët të ri.

Me qëllim të realizimit të synimeve strategjike dhe ngritjes së vlerës së asetëve, KMDK ka përcaktuar synimet operative dhe financiare për vitin 2013 do të angazhohet ti përmbushë këto caqe:

- Shfrytëzimin e Mjeteve financiare nga të hyrat vetanake dhe grandët e ndara nga Qeveria, për Investimet Kapitale nëpër DS, konforme afateve dhe respektimit të kornizës ligjore;
- Rregullimin e lagunës së ujërave të zeza të DS në Prishtinës dhe vendosjen e qëndrueshmërisë në këtë deponi;
- Ngritja e profilit të KMDK si aktor kyç në zhvillimin e sektorit të Deponive sanitare Regjionale në Kosovë;
- Ngritja e nivelit të pajtueshmërisë së KMDK me KRM-të e licencuara, për ofrimin e shërbimeve sipas standardeve të përcaktuara me kornizën Ligjore;
- Konsolidimi i mekanizmave për futjen Partneritet Publiko-Privat në Industrinë e përpunimit të mbeturinave si dhe riciklimin e tyre;
- Prioritet i kompanisë është dhe kryerja e obligimeve ekzistuese (Borxhet) ndaj ish operatorëve dhe ZRRUM;
- Trajnimet e stafit menaxherial, pjesëmarrja në seminare të ndryshme si brenda dhe jashtë vendit.
- Në vitin 2013 do të synojmë të rrisim tarifën për tonelate të mbeturinave që deponohen dhe që kjo tarifë mos të jetë më e ultë se 8.60 euro për tonë.

Për secilin prej synimeve të mësipërme, KMDK ka përcaktuar një sërë veprimesh konkretë të cilat do të ndërmerren dhe në bazë të cilave do të vlerësohet performanca e KMDK SH.A.

7). Rreziqet e të ardhmes së korporatës

Për arsye të vështirësive në inkasimin e të hyrave sidomos nga KRM, borxhet e të cilave janë me miliona euro, KMDK SH.A nuk do të mundet të ju përgjigjet kontraktuesve me të cilët ka raporte biznesore. Disa prej kompanive kanë parashtruar padi në gjykatat kompetentë dhe është e mundshme që një gjë të tillë të bëjnë të gjitha kompanitë të cilave ju obligohet KMDK. Një rrezik në të ardhmen e kompanisë do të jenë tarifatat ekzistuese e vendosura nga ZRRUM. Për qëndrueshmëri të kompanisë është e domosdoshme ngritja e tarifës, për arsye se janë rritë kostot e karburanteve, pjesëve rezervë dhe kostove tjera operative,etj.

Përgatitja e Planit të Biznesit, është bërë sipas parimit të vazhdimësisë dhe zhvillimit të aktiviteteve biznesore për një periudhë të gjatë kohore. Rreziqet e mundshme në pamundësia e realizimit të tij mund të përmbledhet në këtë raport për këto arsye :

- Mosarkëtimi i llogarive të arkëtueshme;
- Mos aprovimi i ngritjes së tarifës së shërbimit (në shkallë të kërkuar);
- Procedurat gjyqësore që janë iniciuar kundër kompanisë;

- Mos zhvillimin e shumë aktiviteteve të parapara me mjete vetanake për shkak të gjendjes të vështirë financiare që ballafaqohet kompania në blerjen e buldozerëve të riinjë aty ku ka nevojë, ndërtimin e gypave gazifikues, etj.

Hapat që duhet ndërmarrë: të blihen dy buldozerë minimum T6 dhe një kamion për bartje të mbeturinave.

Rrezik parqet ngritja e ujërave të zeza në DS- Mirash , nëse krahasohet prej vitit 2010 niveli i ujit është ngrit për 2 metra, kjo ndikon në humbjen e stabilitetit të DS, zvogëlimin e hapësirës operuese ku mund të vjen deri të zhytja e makinerisë dhe rrezikimin e personeli punues.

- Hapat që duhet ndërmarr: - së pari, të trajtohen këta ujëra qoftë përmes rezervuarve të hirit apo përmes impianteve të pastrimit të ujërave të zeza,- së dyti, kthimin e qëndrueshmërisë së DS, - së treti, restaurimin e lagunës si dhe gypave drenazhues të cilët përcjellin ujërat e zeza nga DS në lagunë,- së katërti, aftësimin e pompave ricikluese.
- Stabilizimin e skarpateve nga mbeturinat nëpër DS të cilat janë ngritur 40 m lartësi mund ta rrezikojnë stabilitetin e DS, si dhe rrëshqitjen e trupit të DS.

Hapat që duhet ndërmarr: janë rrëzimi i skarpateve duke i ngjeshur me kompaktorë me pjerrtësi të rënies 1:3 në bazë të standardeve gjeneralë, si dhe mbulimin e tyre me sasi të dheut në mënyrë që të mos kundërmojnë këto mbeturina.

- Mungesa e gypave gazifikues për ajrosje në trupin e DS sipas standardeve gjeneralë të kërkuara në mënyrë që materiet plasëse si metani i cili prodhohet gjatë kalbjes së mbeturinave në kontakt me lagështin mund të vjen të eksplodimi apo ndezja e zjarreve të furishme.
- Hapat që duhet ndërmarr: të instalohen gypat gazifikues, si dhe mbeturinat e ekspozuara të kompaktohen dhe të mbulohen mirë.
- Dëmtimi i gypave drenazhues për ujëra të bardha si dhe të zeza, këto ndikojnë në përzierjen e ujërave të bardha me të zeza ku rritet kapaciteti i ujërave të zeza në lagunë që shkakton kapërderdhjen e saj duke vërshuar ujërat e zeza jashtë trupit të deponis dhe shkaktuar ndotjen e ambientit.
- Hapat që duhet ndërmarr: gypat drenazhues ekzistues të zëvendësohen me të rinj, të ndahen sektorët mirë të izolojnë me argjilë të padepërtueshme nga uji, në mënyrë që ujërat e zeza të mos bien në kontakt me ujërat e bardha, ujërat e zeza derdhen në lagunë ndërsa ujërat e bardha në kanale atmosferike dhe derdhen në recipient (lumë).
- Rrezik për asete sidomos për makinerinë paraqes brejtësit (minjtë), të cilët janë shumë me numër shumë të madhe, të cilit dëmtojnë kabllot e makinerisë e cila operon nëpër DS, si dhe prezenca e gjarpërinjve të cilët mund ta rrezikojnë personelin punues.

Hapat që duhet ndërmarr: këto deponi të deratizohen dhe dezinfektohen nga kompani të specializuar të licencuar nga instituti i shëndetit publik.(është ndarë grandë qeveritar për vitin 2013 në vlerë 100.000,00 euro)

- Forcat tjera madhore (tërmeti, vërshimet,zjarret etj.).

Shqetësim dhe sfida për KMDK SH.A edhe këtë vit ka qenë e do të jetë edhe për vitin 2013 paqëndrueshmëria e deponise sanitare në Mirash, situatë kjo e krijuar që nga viti 2009 kur DS është menaxhuar nga OE Alpenbau. Nga raportimet e viteve të kaluar në vazhdimësi është potencuar Raporti i eksperteve të IFC-Bankës Botërore i vitit 2010, të cilët kanë rekomanduar aktivitetet që duhet ndërmerren në trajtimin e ujerave të zeza dhe për të sjellë DS në situata të qëndrueshmërie dhe funksionale.

Kryeshefi Ekzekutiv i KMDK SH.A

15/03/2013

Z. Abdullah Haxhiu
